



AUTORË BASHKËKOHORË





OMBRA GVG

FB: OMBRA GVG PUBLISHING HOUSE

↓
▲**VTORĚ BASHKĚKHORĚ**
734

traduki

Botimi i kësaj vepre u mbështet financiarisht nga TRADUKI,
një rrjet letrar ku bëjnë pjesë
Ministria Federale për Europë, Integrim dhe Punë të Jashtme
e Republikës së Austrisë,
Zyra e Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë,
Fondacioni zviceran “Pro Helvetia”,
“KulturKontakt Austria” (ngarkuar nga Zyra e Kancelarit Federal
të Republikës së Austrisë),
Instituti “Goethe”, Agjencia Sllovene e Librit “JAK”,
Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë,
Departamenti i Kulturës i Qeverisë së Principatës së Lihtenshtajnit,
Fondacioni Kulturor i Lihtenshtajnit,
Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë,
Ministria e Kulturës dhe e Informimit e Republikës së Serbisë,
Ministria e Kulturës e Republikës së Rumanisë,
Ministria e Kulturës e Malit të Zi,
Panairi i Librit në Lajpcig
dhe Fondacioni “S. Fischer”.



ANDREA FAZIOLI

Një mashtrim i shkëlqyer

ROMAN

Përktheu nga origjinali

LULJETA SHTINO



© 2013 - Ugo Guanda Editore
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.
© 2017 - Shtëpia e librit OMBRA GVG
Të drejtat e këtij botimi janë të rezervuara.

© of the translation:
S. Fischer Foundation by order of TRADUKI

Titulli i origjinalit:
Andrea Fazioli / Un splendido inganno / romanzo
Ugo Guanda Editore S.p.A., 2013
Gruppo editoriale Mauri Spagnol

Në shqip
Andrea Fazioli / Një mashtrim i shkëlqyer / roman
Përktheu nga origjinali Luljeta Shtino

Shtëpia e librit OMBRA GVG - 2017 - Tiranë
Ballina dhe struktura grafike u realizuan nga mvdsdesign/17
isbn: 978-9928-06-174-4

- ▶ info@ombravg.com
- ▶ www.ombravg.com
- ▶ fb: ombra gvg publishing house

NJË MASHTRIM I SHKËLQYER





Shënim i autorit

Nuk kam sajuar asgjë. Të gjitha mashtrimet, për të cilat do të lexoni në faqet në vijim, janë të vërteta: dikush (jo i nënshkruari, duhet të saktësoj) i ka eksperimentuar me sukses në realitet. Disa janë të famshme, disa më të pazakonta, por të gjitha i përkasin traditës së mashtruesve. Dua t'ju shpreh mirënjohjen time atyre që m'i kanë treguar, pa zënë në gojë emra, natyrisht. Përfitoj nga rasti për të falënderuar, përveç mjeshtrave të mashtrimit dhe policëve, edhe personat që më kanë ndihmuar në rishikimin e tekstit.

A.F.

“Midiš nesh... ishte si lojë bixhozi...”

PAOLO CONTE

Gjesa e Parë



Kur mbërriti burri me revole, kafeja ishte gati në të zier.

- Mos lëvizni! - tha burri.

Në atë çast, makina e kafesë lëshoi një fishkëllimë.

- Kafeja! - bërtiti Bepe i përkulur mbi arkë.

- Një sekondë, - u përgjigj Magda, e cila po rregullonte revistat.

- Ej! - tha burri dhe bëri një hap përpara. - Ej, jam i armatosur!

Bepe dhe Magda ngritën sytë te figura e mbështjellë me një pallto, me një shall që i fshihte fytyrën dhe një kapelë të ulur mbi ballë. Vunë re revolen e zezë dhe të rëndë. Askush prej tyre nuk mendoi se qe shaka.

Kur punon në një pikë karburanti, duhet të të shkojë ndër mend, se herët a vonë, dikush do të provojë të vjedhë paratë e arkës. Por janë gjëra që të duken të pabesueshme, edhe kur i sheh tek ndodhin. As Bepe, as Magda, nuk dinin si të reagonin. E ndërkaq, kafeja kishte filluar të nxirrte shkumë.

- Mos lëvizni! - përsëriti burri.

U bindën. Sytë e Bepes vrapuan te makina e kafesë. Guido hyri në lokal dhe u gjend përballë Bepes, i cili po mbështeste makinën e kafesë mbi banak. Magda e ndiqte me sy. Në të djathtë, pas saj, qëndronte burri me revole. Guido ngriu. Për një të qindtën e sekondës mendoi të kthente kurrizin e të dilte. Askush s'kishte hapur gojë ende. Bepe qëndronte me makinën e kafesë në dorë dhe me pamjen e dikujt që kapet në faj. Magda rrahu qepallat.

- Ti, eja këtu! - tha burri me revole.

Guido, gjatë jetës së tij s'ishte ndeshur kurrë me dhunën. E kishin rrahur dhe kishte rrahur kur qe djalosh; i kishte ndodhur te grindet me më shumë se një person; por asnjë i rritur nuk e kishte kërcënuar kurrë kaq rëndë.

Tani, një i panjohur i kishte drejtuar armën; një revole. Diçka që mund të shtinte dhe të vriste. Aksidentet, grabitjet, sulmet: gjithçka që lexojmë nëpër gazeta. Guido nuk ishte mësuar me adrenalinë, me rrahjen e furishme të zemrës. Prandaj, edhe ai vetë u habit me gjakftohtësinë e tij, por edhe me sigurinë e tij, me të cilën iu afrua burrit e i tha: - Të ruajmë qetësinë.

- Ka ndonjë tjetër këtu? - pyeti burri.

Guido vështroi Bepen, që kruajti zërin dhe u përgjigj: - Është edhe Lino me Fiorencën, por ...

- Thuaju të vijë këtu!

- Por ...

- Bëj si të thotë, - ndërhyri Magda.

Lino e Fiorenca Kostantini ishin prindërit e Magdës, pronarët e pikës së karburantit. Bepe Torre, që ishte disa vjet më i madh se Magda, ishte mekanik dhe kishte ca vjet që punonte aty. Guido Moreti ishte më i moshuar, tek të gjashtëdhjetat, dhe merrej para së gjithash me llogarinë.

Bepe i ra ziles për të thirrur Linon dhe Fiorencën. Burri me revole urdhëroi që ta mbyllnin portën me çelës. Pastaj i vuri të mbështeteshin te muri dhe iu afrua arkës. Në heshtje, të gjithë ndienë erën e kafesë tek përhapej nëpër dhomë. Burri me revole zbrazi me shpejtësi arkën. Menjëherë pas kësaj, hyri Lino dhe Fiorenca. Lino e kuptoi në çast ç'po ndodhte. Fiorenca mbajti gojën me dorë, kaloi vështrimin nga grabitësi te vajza e saj, që rrinte në këmbë te muri, pranë Bepes dhe Guidos.

- Çdo gjë në rregull mama, - tha Magda. - Do vetëm paratë.

Lino nuk fliste, ia kishte ngulur sytë revoles. Kishte ngrysur vetullat dhe kishte shtënguar buzët. Grabitësi e vuri re vështrimin e tij.

- Ti je shefi? - pyeti

Lino nuk u përgjigj.

- Ti je shefi? - pyeti përsëri grabitësi, duke hedhur një hap drejt tij.

Lino pohoi me kokë.

- Ku është kasaforta?

Lino nuk u përgjigj.

- Pyeta ku është ...

- Nuk ka kasafortë, - tha Lino. - Nuk kemi më asgjë.

Grabitësi ndaloi para tij dhe ngriti revolen.

- Të pyeta ku është kasaforta.

Kaluan disa sekonda, pastaj Magda tha: - Baba ...

- I morët paratë, apo jo? - Ia priti Lino. - Atë donit!

Grabitësi u afrua më shumë dhe ngriti revolen deri te fytyra e Linos.

Guido ndërhyri: - Lino, të lutem!

Lino u kthye përnjëherësh drejt tij. Vështroi të shoqen, vajzën dhe Bepen. Në fund, uli sytë dhe tha: - Kasaforta është andej.

Deri te magazina mbrapa, duhej kaluar nëpër një korridor. Pasi kaloje magazinën, pas një korridori tjetër të shkurtër, ishte zyra e Linos me kasafortën.

Burri me revole i urdhëroi të gjithë të ecnin para tij, dhe ata u vunë në rresht: Bepe, Guido, Magda, Fiorenca, dhe i fundit, Lino.

Në mes të rrugës, në fund të korridorit të parë, Lino filloi të mos ndihej mirë. Vuri dorën mbi zemër dhe u përkul në gjunjë. Grabitësi bëri një hap mbrapa dhe i drejtoi revolen.

- Nuk mundem, - gulçoi Lino. - Nuk mundem ...

Magda dhe Fiorenca u përkulën mbi të. Grabitësi

u nervozua dhe shtyu përpara Bepen dhe Guidon.

- Ju dini ta hapni kasafortën?

- Po! - u përgjigj Bepe. - Por ...

- Shkojmë!

Kështu, burri me revole, bashkë me Guidon dhe Bepen, kaluan magazinën dhe arritën te zyra, duke lënë pas Linon që dihaste, i ndihmuar nga dy gratë.

Sapo u largua grabitësi, Lino e mori veten menjëherë.

- Shpejt! - e urdhëroi Magdën. - Thirr policinë!

- Nuk ndihesh keq? - belbëzoi ajo.

- Bëra gjasme, jepi, shpejt! Jepi, thirr policinë!

Ishte një e premtë pasdite, dhe në kasafortë kishte një shumë të konsiderueshme të hollash. Grabitësi mbylli derën e zyrës, pastaj i tha Bepe: - Më trego paratë!

Bepe u bind. Sapo hapi derën, grabitësi e urdhëroi të hiqej mënjanë. Verifikoi që paratë ishin aty, pastaj detyroi Bepen dhe Guidon të mos lëviznin. Në fund, doli nga zyra.

- Ç'po bën? - pyeti Bepe.

- Po shkon te të tjerët, - tha Guido.

Thuajse për pesë sekonda qëndruan ashtu, duke u vështruar, në këmbë, përballë njëri-tjetrit. Guido ishte një burrë i gjatë dhe i dobët, me fytyrë të zgjatur, sy të çelët e me flokë paksa të thinjura. Format e trupit i kishte si me cepa, sikur ishin marrë nga një model origjinal prej guri. Bepe ishte më i ri, me forma më të lakuara, me flokët pis të zeza. Sytë e rrumbullakët, ngjyrëlaçthi, i shkuan vërtik, nga dera e mbyllur, te Guido, pastaj përsëri te dera, e më në fund iu ndalën te kasaforta.

- Kemi pak kohë.

Guido e pa, pa kuptuar gjë. Bepe i tregoi derën gjysmë të hapur.

- Tipi me revole nuk i numëroi. Nuk mund t'i marrim të gjitha, por nëse mungon gjësend, nuk do t'i bjerë në sy ...

Guido nuk lëvizi.

- Jepi, shpejt ...!

Kushedi për ç'arsye, Bepe nuk i përllante dot paratë vetë. Ndoshta kishte frikë se Guido mund ta denonconte.

Nga ana e tij, Guido nuk donte të zihej me Bepen, sidomos gjatë një grabitjeje.

- U bënë vite që punon këtu, - i tha Guido.

- Pikërisht. Tani më erdhi rasti në dorë.

Guido hezitoi, pastaj uli sytë.

S'arrinte të kuptonte pse i dukej normale gjithçka po ndodhte: silleshin sikur i kishin mësuar përmendsh batutat dhe gjestet, sikur grabitësi dhe viktimat po ndiqnin një skenar. E megjithatë, nuk kishin pasur kurrë përvoja të drejtpërdrejta me këto lloj ngjarjesh. Ose të paktën, asnjëri prej tyre nuk i kishte zënë ndonjëherë në gojë. Stacioni i karburantit ishte në Novacano, një nga komunat më jugore te Zvicrës, afër kufirit me Italinë. Kalonin shumë makina, sidomos ata që udhëtonin nga njëri vend në tjetrin, për punë. Punë kishte sa të doje, çdo ditë e njëjta rutinë: po

ato targa, po ato fytyra. Ngajëherë kishte ditë më të ngarkuara, nganjëherë ditë me pak punë. Ndodhte që të kalonin persona interesantë, me dëshirën për të shkëmbyer dy llafe. Por, asnjë hajdut. Të paktën deri atë pasdite nëntori. Askujt s'i kishte ikur mendja. Ndoshta ishte një maturi që e fitojnë ata që punojnë me paranë. Në një farë kuptimi, edhe grabitja ishte pjesë e rutinës, si të bëhej fjalë për orë jashtë orarit, asgjë e jashtëzakonshme, përveç faktit që Bepe donte të fuste paratë në xhep. Guido nuk dinte si të reagoje. Deri në atë çast kishte kujtuar se kishin të bënin vetëm me një telash, megjithëse më i bezdisur se zakonisht: mjaftonte të shmangnin lëvizjet e gabuara dhe askush nuk do të prekej.

Po tani, cila ishte lëvizja e duhur?

Karburanti ndodhej në rrugën “Boskerina”, pak jashtë qendrës së Novacanos. Në atë orë, zakonisht kishte trafik. Por askush nuk ndaloi, askush nuk dyshoi nga dera e mbyllur. Magda dhe Fiorenca nuk ia vunë veshin Linos, kur bëri sikur i ra të fikët: të merrje policinë, qe shumë e rrezikshme. Burri me revole i futi paratë në një çantë, pastaj mori celularët dhe telefonin e zyrës. I urdhëroi të gjithë të mos lëviznin dhe doli duke mbyllur derën pas vetes. Pas disa minutash, e hapën zyrën me çelësin rezervë që ishte në një sirtar të skrivanisë. Shpejtuan të gjenin një telefon. Policia erdhi, bëri pyetje, mbajti shënime dhe bëri vlerësime e komente. Por, pavarësisht postbллоqeve, grabitësi padyshim e kishte kaluar kufirin tanimë. Guido Moreti u kthye vonë në shtëpi atë ditë. Lino, i xhindosur, ishte ngjitur në apartamentin e vet, i shoqëruar nga Fiorenca. Gjëja më normale do të kish qenë ta mbyllnin dyqanin, por asnjërit prej tyre s’ia bëri zemra. Kështu që Bepe u kthye në banak, zbrazti makinën e kafesë dhe përgatiti një kafe tjetër. Magda vazhdoi të vinte rregull dhe

Guido doli të priste klientët. Pjesën tjetër të pasdites, Guido dhe Bepe nuk folën gati fare me njëri-tjetrin. Në atë çast, Guido nuk e kuptoi, por gjithçka filloi të ndryshonte. Natyrisht, ishte një proces i ngadaltë: vështirë t'ia përcaktoje saktësisht shkaqet. Por Guido mbeti gjithnjë i bindur se grabitja shënoi fillimin e një jete të re për të.

Atë pasdite, i pranoi si gjithmonë bakshishet e klientëve dhe i vendosi te arka e kuqe e kursimit mbi banak. Hajduti nuk e kishte prekur. Magda u mundua të buzëqeshte: - Të paktën bakshishet shpëtuan ...

Bepe qeshi me të, por Guidos ama iu duk se shqoi nje fije shtirjeje.

Magda u ngjit në katin sipër, për të parë si ishin prindërit, ndërsa Bepe përfitoi për t'ia mbathur me shpejtësi. Guido qëndroi edhe pak, për të përditësuar sistemin e kontabilitetit në kompjuter dhe për të pyetur veten nëse duhej të thoshte ndonjë gjë. Por s'kishte më asgjë për të thënë. Ajo që u bë, u bë. Guido nuk e kishte zakon t'i bluante shumë gjërat. Por kësaj here, diçka mbeti si e pazgjidhur, si një mendim që nuk arrin ta mendosh deri në fund. Kur iku jashtë, bënte ftohtë. Guido ishte si i ftohur. Me motorin e vet, shmangu rrugën kantonale, mori sipër, për te rruga "Gaxhio", e më pas, te rruga "Bosketo". Para se të shkonte në shtëpi, kishte kohë të pinte ndonjë pije të ngrohtë te Stela. Rrëpira me vreshta ishte e errët. Nga një shtyllë te tjetra, në rrugën e përpjetë, i ftohti dukej më i madh.

Guido zbriti nga motori dhe ndaloi të merrte frymë. Nga larg dëgjoi motorin e një makine që vinte me shpejtësi. Era e lehtë lëvizte degët e pemëve, anash rrugës. “Më kanë grabitur”, mendoi Guido.

Ndiente se i qe bërë një padrejtësi, dhe në njëfarë kuptimi, kishte të drejtë, megjithëse, tek e fundit ai nuk ishte pronari i pikës së karburantit. Ajo që e mërziste më shumë, ishte ndërprerja e normalitetit. Brenda një çasti, kishte dalë në shesh thelbi i secilit. Dinakëria e Linos, pandershmëria e papritur e Bepes.

“Pandershëmëria” ishte një fjalë e vjetëruar për të përshkruar atë që kishte ndodhur. Guido nuhaste që bëhej fjalë për diçka më intime. Bepe kishte thënë që gjatë gjithë këtyre viteve punë për Kostantinët, s’kishte bërë gjë tjetër, veçse kishte pritur t’i vinte rasti. Po Guido, çfarë po priste?

Drita e verandës ishte e ndezur. Guido e ktheu motorin përgjatë rrugicës së pjerrët dhe e parkoi jashtë gardhit. Kur u bë gati t’i binte ziles, një fëshfërimë ia tërhoqi vëmendjen. U shfaq Stela: e mbështjellë me xhaketën e saj të madhe, të verdhë, si të një marinari, e me beretën që i mbulonte veshët.

- Shih kush qenka! - qeshi Stela. - Paskemi mbërritur në të njëjtën kohë!

Guido vuri re, që si zakonisht, ajo kishte me vete shportën prej xunkthi.

- Paske dalë të mbledhësh barishte tani natën?

- Gjëra të vogla. Sot vura re që rrepanët afër

kopshteve qenë pjekur dhe nuk doja t'i çoja dëm ...
Po ti, je me grip?

- Unë? S'besoj.

- Edhe po s'ishe, është duke të të zënë. Eja brenda, të të bëj ndonjë gjë!

Stela përgatiste gjithnjë çajra. Ose përzierje lulësh e gjethesh, si në këtë rast. Guido nuk e dinte mirë ndryshimin, ndoshta kishte të bënte me momentin kur hidhte ujin e vluar. Sidoqoftë, Stela i dha një filxhan çaji trumze dhe derdhi mbi tryezën e kuzhinës rrënjët e rrepanëve.

- Je me fat që gjeta këto, - i tha duke marrë dërrasën e kuzhinës dhe një thikë. - Rrepani i freskët të liron rrugët e frymëmarrjes dhe nuk lejon ...

- Por, unë nuk ...

- ... dhe të shpëton nga gripin. Për më tepër, ka dhe aromë të mirë.

- Jam mirë, po të them. D.m.th, ndoshta jam pak i ftohur, por jo ndonjë gjë kushedi se çfarë.

- Ja, e sheh? Ku je ftohur? Ke ndenjur jashtë?

- Po, pak, pasdite.

Stela Glauser ishte pesëdhjetë e pesë vjeçe dhe punonte në postën e Novacanos. Ishte një grua e imët, me linja të holla; vajzat e Guidos, kur ishin të vogla, e kujtonin për ndonjë krijesë pylli. Në fakt, kishte dekada që ishte transferuar në Tiçino, nga Zvicra gjermane, për një punë si *dado*, dhe kishte mbetur aty. Guido mendonte se shkakun mund të kishte qenë ndonjë

burrë, por nuk e kishte pyetur kurrë. Sepse, zakonisht ishte ajo që i bënte të tjerët të flisnin. Në fakt, pas disa minutash, Guido i rrëfeu që ishte i inatosur me Bepen.

- E ç'të ka bërë Bepe?

- Sot ishte një ditë e çuditshme.

Stela lëvizte nëpër kuzhinë në një mënyrë të zhdërvjellët. Ndezi *stereon* dhe ia uli volumin. Guido njohu muzikën e "Beach Boys", një nga pasionet e mëdha të Stelës. Ajo i mbante ritmin me kokë, pastaj mori fshesën dhe filloi të pastronte dyshemenë nga rrënjët e rrepanëve.

- Çfarë të ka ndodhur sot?

- Një burrë vodhi në pikën e karburantit.

Stela u kthye, me duart pis me dhe, siç ishte.

- Si?

- Hyri me revole dhe i mori të gjitha paratë e arkës e të kasafortës. Do kenë qenë disa mijëra franga.

- Një i vetëm?

Nuk pamë të tjerë. Ndoshta, jashtë do ketë qenë dikush me makinë.

- Kushedi sa janë trembur Kostantinët!

- Lino u xhindos. Për pak sa s'mori ndonjë plumb.

Stela shpëlau rrënjët e rrepanëve dhe i vuri mbi dërrasë.

- Duhet të hash dhe ca të freskëta, të hapin mushkëritë. Pjesën tjetër do ta lë në uthull, me pak verë të bardhë dhe dëllinjë është një salcë e shkëlqyer.

Filloi të grijë rrënjët. Guido e vështronte përmes

avullit që dilte nga çaji. Prerja në formë gjysmëhëne, sa para prapa mbi dërrasën e kuzhinës, po e hipnotizonte.

- E more vesh për Livian, gruan e Korrados? - Stela fliste me vete, duke mbushur heshtjen. - Është zhdukur më duket. Ai thotë që e kanë sulmuar derrat e egër.

- Çfarë?

- Kishte dalë me qenin, kur i dolën përpara derrat e egër. Njëri ia nguli dhëmbët qenit në stomak. Pastaj, veterineri u detyrua ta vriste. Nuk është hera e parë që derrat e egër u afrohen qendrave të banuara: ndoshta duhet të mbronin të vegjlit, kushedi!

- Më fal, po Livia?

- Livia u zhduk, të thashë. Gjetën gjakun e saj te shtegu. Sipas Korrados, kanë qenë derrat e egër ...

Guido e humbi durimin.

- S'besoj ta kenë ngënë derrat e egër!

Stela ndaloi së preri rrepat në formë gjysmëhëne.

- Nuk më the pse e ke inatin me Bepen.

Guido i ngriti sytë menjëherë. Kështu e kishte Stela: i tregoje për një grabitje, e sillej sikur i kishte treguar një thashethem, pastaj, papritur e sillte prapë bisedën aty.

- Gjatë grabitjes, unë dhe Bepe mbetëm vetëm, në zyrën e Kostantinit. Kasaforta ishte e hapur. Para se unë të bëj llogaritë e të shtunës pasdite, as Kostantini, nuk e di saktësisht sa para ka aty brenda. Dhe Bepe...

Guido ngurroi. Iu duk e rëndësishme që të zgjidhte fjalët e duhura.

- Bepe më kërkoi të përfitonim nga rasti.
- Ah! - tha Stela dhe mblodhi me dorë copat e rrepanëve. - Po ti?
- Ai u afrua të merrte paratë, por në atë moment, dëgjuam që të tjerët po ktheheshin.
- Pra, nuk i mori.
- Jo. I mori të gjitha hajduti.
- Shkoi mirë, apo jo?
- Stela kishte vënë buzën në gaz.
- Në njëfarë mënyre ...
- Edhe Guido buzëqeshi.
- Po, ka diçka që s'e gëlltis dot.
- Stela i drejtoi një vështrim pyetës.
- Unë vija dorën në zjarr që Bepe e donte punën, që s'mund të vidhte kurrë asgjë.
- Do të ketë menduar: midis meje dhe hajdutit, më mirë t'i marr unë.
- Pikërisht, ai dhe hajduti: sikur të ishin në të njëjtën barkë. Nuk pritej prej Bepes kjo, më kupton? Rrethanat e bënë të nxjerrë një fytyrë tjetër.
- E kuptoj. Po ai të mban mëri?
- Them se po. Kujtoja se e njihja Bepen. Ajo që më frikëson, është se këto raste, siç i quan ai, mund të përsëriten prapë. Kush më siguron që herës tjetër nuk do të jetë radha ime?
- Guido bëri një pauzë.
- E di që është një arsyesim i pështjelluar ... kam gjithë pasditen që e mendoj.

- Është normale, - tha Stela, që mbaroi së mbledhuri rrepanët. - Por vjedhjet nuk ndodhin përditë. Ti nuk lëshove pe, dhe në fund, as Bepe s'i mori paratë. Për mua, kësaj pune iu vu kapak.

Guido që zhytur në mendime.

- Të shpresojmë, - mermëriti. - Të shpresojmë që është kështu.

Stefan Aigër e donte të bukurën. Madje, ndoshta donte “bukurinë”. Ishte ekspert verërash, që prej kohëve të universitetit, dhe së fundmi, po studionte artin dhe antikuariatin. Puna e tij e çonte drejt fushave të tjera: më shumë se për “bukurinë”, bëhej fjalë për “saktësinë”. Stefani mbulonte një detyrë të rëndësishme në një bankë private, ku drejtonte një grup bashkëpunëtorësh të specializuar, që merreshin me klientë të rëndësishëm. Ishte një detyrë me përgjegjësi, prandaj Stephan-i nuk bënte lëshime për detajet. Teksa shijonte një birrë te “Kundi”, në Bahnhofstrase, mendonte: “Në fund të fundit, edhe bukuria përbëhet nga detajet; ose nga ‘Detajet’, ndoshta”. Dëshmi e kësaj ishte Zyrihu: rregulli, pastërtia e harmonia mes historisë dhe modernizmit krijojnë një harmoni që e bënte një nga qytetet më të përshtatshëm në botë për të jetuar. E ç’do të thotë “i përshtatshëm për të jetuar”? Do të thotë, që një biznesmen të mund të shijojë një aperitiv në një lokal të zgjedhur, me klientelë të zgjedhur, ku mirësjellja është diçka e natyrshme.

Kur hyri gruaja e ngarkuar me qese e çanta, kamerieri i kërkoi disa herë të falur Stefanit. Edhe gruaja që fliste në telefon me kufje, e ndërpreu bisedën, për të shprehur keqardhjen e vet.

- Asnjë problem, - tha ai, i pavendosur nëse duhej të çohet për ta ndihmuar. Pastaj qëndroi ulur: nuk donte të dukej si dikush që perzihej në punët e të tjerëve.

Por, ama, nuk mundi të rrinte pa e dëgjuar telefonatën, megjithëse zhvillohej me një nivel zëri më se të matur.

Me sa dukej, gruaja punonte si ai, në *Private Banking*, dhe sapo kishte pranuar një vend pune në Singapor.

- Jo se më vjen keq, - thoshte, ose më saktë mër-mëriste. - Këtë punë, kam një jetë që e ëndërroj... Por më erdhi papritur, kupton? Jo, shtëpinë duhet ta lë, por nuk kam shumë gjëra ... Po, kur vdiq hallë Vera, i mora unë gjithë pikturat dhe mobilet e saj... T'i shes? Patjetër, por tani nuk kam kohë... *Ok, Ok*, e rëndësishme është që më dhanë këtë punë. Po, ke të drejtë. Dëgjohemi sonte.

Stefani e vërejti gruan edhe më ngultas. Ishte rreth të dyzetave, ndoshta më shumë, por tregonte më pak. Kishte trup me forma të mira, kostum gri në nuancat e tymit, me flokë ngjyrëgështenjë, të lëshuara mbi supet dhe gojë të lëvizshme. Sytë i kishte të qeshur edhe kur nuk buzëqeshte, a thua se qe mësuar të shihte anën pozitive të gjërave.

Ndërsa gruaja i përgjigjej një telefonate tjetër, Stefani

u hodhi një sy çantave të saj. Vuri re se bëhej fjalë më së shumti për piktura, bashkë me çikërrima zbukuruese: kana, disa statujëza dhe një kuti e dekoruar me një formë të çuditshme, jo plotësisht simetrike. Gruaja fliste për punën e saj të re, ndërsa Stefani u kthye te birra e vet. I ishte bërë zakon të ndalonte aty, pas pune. “Kundi” ishte një nga ata lokalet e reja, që investojnë shumë për mobilimin: divane të verdha dhe të ulëta, në formë tërëfil katërgjethësh dhe tavolina kristali të ndriçuara nga brenda. Kishte gjithashtu edhe kolona mermeri, në majë të të cilave kishte nga një vazo me margarita artificiale.

Gruaja quhej Kerin. Stefani e zbuloi te telefonata e tretë. E kuptoi që për të ishte normale të ulej në një bar dhe ta kalonte kohën me celular. Stefani nuk ishte as dhjetë vjet më i madh se ajo, por ndjeu se i përkiste një brezi tjetër.

Papritur, një telefonatë e bëri të tundej nga vendi më shumë se të tjerat.

- Si, tani? Patjetër Zoti Braun, por unë... Ah, po, takohemi te stacioni i tramvajit. Po sigurisht që nuk mund të nisem siç ishte parashikuar më... sigurisht, sigurisht, është e qartë. Dakord, unë jam në një bar por... dhjetë minuta, po, mund të dal një çast.

Kerin përfundoi bisedën dhe vështroi rreth e rrotull me një pamje të përhumbur. Stefani e mori me mend që diçka i kishte përmbysur planet saj. Pastaj, me habi, e kuptoi që gruaja po mundohej t’i tërhiqte vëmendjen.

- Më falni zotëri, nuk desha t'ju shqetësoj, por...
Stefani e dalloi që ajo ishte në siklet.

- Ju lutem, - i tha. Nuk më shqetësoni.

- Duhet të dal për një porosi, sa të marr disa dokumente. Nuk e di a mund t'u hidhni një sy gjërave të mia ... kthehem për pesë minuta. Por në qoftë se duhet të ikni ...

- Pa problem, - i tha Stefani. Mund të ikni, unë këtu do të jem.

Kerin e falënderoi dhe doli me vërtik nga lokali. Stefani piu një gllënjë birrë dhe vuri buzën në gaz. Edhe kujdesi kur i flisje një të panjohuri, edhe takti, ishin "Detaje" karakteristike të Zyrihut. Prandaj, njerëzit kishin besim te njëri-tjetri: Kerin i kishte kërkuar pa ngurrim të ruante gjërat e saj, megjithëse nuk njiheshin.

- Më falni ...

Stefani ngriti kokën. Dy burra me kostum e kravatë, të ulur në tavolinën përbri, vështronin në drejtim të tij.

- Po flisni me mua?

- Po, më falni për shqetësimin, po vura re kutinë e cigareve.

- Si thatë?

Burri kishte gati moshën e Stefanit dhe kishte veshur me një kostum prej nëpunësi banke. Bëri me shenjë nga gjërat që kishte lënë Kerin.

- Nuk rastis gjithmonë të shohësh një kuti cigaresh të shekullit të XVI-të. Nga të parat fare, në qoftë se

është origjinale, siç duket. E stilit francez, në mos gaboj ...

Stefani e kuptoi që e kishte fjalën për kutinë e zbukuruar.

- Oh, nuk është imja. Është e një gruaje që doli një minutë, për një porosi...si thatë?

- Dhe e la këtë send të paruajtur?

Kishe folur burri tjetër, ai më i riu.

- Jo, s'është tamam kështu, - Stefani u acarua. - Më kërkoi mua t'i hidhja një sy.

- Sa besim që paska, - tha burri më i ri me një ton që Stefanit i tingëlloi si shumë arrogant. Vendosi ta injorojë e t'i kthehet birrës së vet, por burri më i vjetër e pyeti: - Nuk dua të tregohem i paturp, po ju e dini sa vlen një kuti cigaresh e shekullit të XVI-të?

- Nuk e dimë me siguri nëse është autentike, - ndërhyri burri më i ri.

- Ka një jetë që punoj në këtë fushë, - debatoi tjetri.
- Di ta dalloj një objekt të tillë, kur e shoh.

Stefani pa me kureshtje burrin më të moshuar. E kishte kujtuar për sekser, por me sa dukej ishte gabuar.

- Merreni me antikuariate?

- Mund të them që kam lindur mes tyre.

Burri i zgjati një kartvizitë dhe Stefani u hodh përpjetë nga habia. Merrte dhe ai pak vesh nga këto punë dhe e kishte njohur me kë kishte të bënte.

- Zigentaler ... pra jeni i afërm me pronarët e ...

- Është biznesi i familjes, mund të themi. Përgjegjës

është vëllai im i madh, por të gjithë kemi një jetë që punojmë atje.

- E dini që javën e kaluar bleva disa gjëra te ju? Dy pasqyra veneciane dhe një orë muri.

- Ah më kanë thënë më duket ... që morët dhe ato karriget stil "Luigj Filip", prej druri arre?

- Jo, do të ketë qenë dikush tjetër. Stefani buzëqeshi, duke i zgjatur edhe ai kartvizitën e tij. - Por po ta dija, edhe mund ta kisha menduar.

- Herë tjetër do t'ju kontaktojmë. Edhe Zigentaler buzëqeshi. - Për sa i përket kutisë së cigareve ... mund ta shoh?

- Siç ju thashë, nuk është imja. Por nëse doni t'i hidhni një sy ...

Stefani mendoi, që as Kerinit, edhe pse nuk po dukej gjëkund, nuk do t'i vinte keq të dëgjonte vlerësimin e një eksperti. Zigentaler mori kutinë e cigareve dhe kaloi gishtërinjtë mbi reliev. Pastaj e ktheu mbrapsht, dhe nga buzët gjysmë të mbyllura i doli një fishkëllimë habie.

- Fiks siç e thashë. Shekulli XVI, franceze. E dyqanit "Tabarin", e shihni simbolin? Dallohet që është autentike, mes të tjerash, nga gabimi te gdhendja në anë, e shikoni? Kapaku ka rreth e qark një fill të artë, sikurse dhe pllaka poshtë që është prej ari. Përputhet me të njëjtën teknikë që është zbatuar në triptikun e Vermierit, ku Tabarini ...

- Mirë, mirë, - e ndërpreu duke buzëqeshur burri më

i ri. - Nuk besoj që zotërisë i interesojnë konferencat!

- Edhe unë marr vesh nga pak, - nxitoi të saktësonte Stefani.

- Oh, sigurisht!

E tha pa buzëqeshur, por Stefani e dalloj ironinë dhe u acarua. Zigentaleri ia paraqiti.

- Zoti Maier, një nga klientët tanë më të mirë.

Stefani shkëmbeu një përshëndetje me kokë, pastaj u kthye përsëri nga Zigentaleri.

- E dini? Do të më pëlqente ta kisha këtë kuti cigresh. Sa mund të kushtojë?

- Rreth dyzet, dyzet e pesë mijë franga, - u përgjigj tregtari i antikave. - Por për një koleksionisht të specializuar, edhe më shumë. Përveç faktit që ka pllakën prej floriri, ky objekt është, në mënyrë absolute, një nga kutitë e para të cigareve, meqenëse kur u zbulua Amerika ...

- Po, po, - Maier e ndërpreu përsëri, pastaj iu drejtua Stefanit.

- Mendoni që pronarja do dojë ta shesë?

- Nuk e di.

Stefani mori kutinë e cigareve dhe e vuri përsëri te gjërat e Kerinit.

- Më duket se e ka trashëguar nga familja.

- Po u kthye për pesë minuta, mund ta pyesim, - tha Zigentaler. - Do të doja t'i bëja një ofertë.

Stefani u gëzua kur kaluan pesë minuta dhe Kerini nuk u kthye, madje akoma më shumë kur kaluan

dhjetë minuta, dhe dy burrat u detyruan të iknin.

- Kemi një takim për një shitje të rëndësishme, - shpjegoi Zigentaler e Stefani u mundua të mos i hidhte sytë nga buzëqeshja me epërsi e Maierit.

Pas disa minutash, Kerin u kthye. I merrej fryma, dhe natyrisht po fliste në celular. E ndërpreu bisedën për t'i buzëqeshur Stefanit dhe për të kërkuar ndjesë për vonesën. Pastaj u ul, gjithmonë duke folur në telefon, dhe hoqi xhakëtën duke u bërë lëmsh me mëngët dhe me kufjet.

- Do që të nisem përpara, më kupton? Dhe unë duhet të mbartem nesër! Po rraquet e hallë Verës ç't'i bëj? Po, po magazina kushton ... mirë, mirë, më jep fjalën që kur të kesh kohë do t'i vësh në papafingo, në rregull? Disa gjëra po i çoj te Krista se i kam me vete dhe ... Po, dakord, shihemi pastaj, mirupafshim!

Kerin hoqi kufjet dhe e falënderoi përsëri Stefanin.

- Ju lutem, - i tha ai. - Nuk bëra asgjë. Në fakt, më falni, por ishte e pamundur të mos dëgjoja që doni t'i hiqni qafe këto ... këto rraquet ...

Kerin u skuq.

- Oh, më falni që ju shqetësova me telefonatat e mia!

Jo, asgjë. Doja thjesht t'ju thoja, që në qoftë se ju intereson, ndoshta mund të blija disa.

- Ju?

Stefani pohoi.

- Po ç'ju duhen? Dua të them ... janë gjëra të vjetra dhe pa shije.

- Nuk ka gjë.

Stefani buzëqeshi.

- Më pëlqejnë gjërat e vjetra.

- Do të më bënit vërtet nder. Kam marrë me qira një magazinë, por më duket se kam pak vend. Doni t'i blini të gjitha?

- Mund t'ju bëj një ofertë. Sa mendoni që vlejnë?

- Nuk e di.

Kerin vështroi sendet e grumbulluara në çanta dhe pikturat që dilnin jashtë qeseve. - Kam frikë që nuk vlejnë shumë. Halla ime, Vera, e kishte shtëpinë plot me çikërrima. Po kornizat e pikturave janë të bukura, ato po. Një mik më ka thënë që mund të fitoja deri në dy ose tre mijë franga, por ndoshta e ka tepruar ...

- Po, sigurisht ...

Stefani rrudhi ballin, sikur po vlerësonte situatën.

- Shikoni, meqë jam koleksionist, mund t'ju ofroj, të themi, pesë mijë franga për të gjitha. Si thoni? Është dyfishi i vlerës së kornizave.

- Pesë mijë franga! Po nuk janë shumë?

- Mos u shqetësoni.

Stefani buzëqeshi.

- Ju thashë që më pëlqejnë gjërat e vjetra, apo jo?